



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 27/2010

Prishtinë, 07. 07. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Mursel Haljilji, Adem Grabovci, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, Mufëra Şinik, Qamile Morina, Zef Morina dhe deputetët Emrush Xhemajli dhe Naim Rustemi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Shala, Liridon Mavriqi – MEF; Tatjana Kucher, Tibar Kartik, Agron Kamberi, Arsim Bruçaj – Telco AG; Mehdi Pllashniku – MTI-ARBK; Haxhi Gashi- USAID, Sanije Berisha – OSCE, Besim Zeqiri –ICO; Besnik Ramadanaj – KDI; Lorik Ramadani – ÇOHU; Milazim Allshiqi, Avni Çallaku dhe Ramadan Makolli – SP-PTK dhe Ibrahim Krasniqi konsulent.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 29.06.2010;
3. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr.03/L-210;
5. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 29. 06. 2010

Adem Salihaj – paraqiti vërejtje për pikën e III-të të rendit të ditës, në faqen e gjashtë (6), ku theksoj se në vend të fjalës “*imitim*” duhet të jetë “*emitim*”.

Kryetarja – paraqiti vërejtje tek pika e V-të ii) në të Ndryshme, ku theksoj se duhet të shtohet paragrafi, si në vijim: Grupi punues për Projektligjet e energjisë ka këtë përbërje: Ethem Çeku, Myzejene Selmani, Adem Grabovci, Fatmir Rexhepi dhe Kaqusha Jashari.

Procesverbali i mbledhjes së 29. 06. 2010 u miratua më vërejtjet e cekura më lartë.

3. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës;

Kryetarja – njoftoi se më Përfundimin e Kryesisë Nr. 03 - P - 246 datë 29 qershor 2010, është ngarkuar Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, që ta shqyrtojë Propozim – Strategjinë e Privatizimit të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, dhe Kuvendit t’i paraqes Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm. Komisioni ka ftuar ministrin e Ekonomisë dhe Financave z.Ahmet Shala, për të paraqitur sqarime në lidhje me këtë Strategji, të cilit ia kaloj fjalën.

Ahmet Shala, ministër i Ekonomisë dhe Financave – theksoj se sot para Komisionit mund ta elaborojmë participimin e Strategjisë të sektorit privat në Post Telekomunikacionin e Kosovës. Në vitin 2008 Qeveria e Kosovës duke u nisur nga politikat afatgjata të MTPT dhe strukturimin e ekonomisë ka themeluar grupin ndërmintor për analizën të sektorit privat në Telekomunikacionin e Kosovës, i cili përbëhet nga ministri i ekonomisë dhe financave - MEF, ministri i MTPT-së, ministri i punës dhe mirëqenies sociale – MPMS, ministri i pushteti lokal MPL, ministri i tregtisë dhe industrisë - MTI dhe ministri i ambientit – MAPH, kanë analizuar dhe ndërtuar strukturën e institucioneve të rëndësishme kështu që është njësia për implemetinin e projektit që përbëhet nga drejtori dhe ka angazhuar një këshilltar të transaksionit e cila kompani është Telko AG dhe Wolfans. Për të ardhur në një analizë më të konkluduar të cilën ju e keni marrë, neve e kemi ekzagjeruar të gjitha aspektet e Post telekomunikacionit të Kosovës së bashku me ekspertet e përmendur aspektin ligjor, aspektin financiar, aspektin komercial kryesisht edhe të gjitha kornizat rregullative. Në shkurt të këtij viti pas një analize mjaft të mirë, neve kemi angazhuar edhe një konferencë të investitorëve të cilëve mund të ju raportojë ka qenë një bashkëpunim i kënaqshëm me të cilët kanë qenë mbi 12 kompani të cilët kanë marrë pjesë kanë paraqitur vërejtejet sugjerimet dhe kërkesat e tyre, dhe gjatë të gjithë kësaj kohe transaksioni i ka paraqitur të

gjitha gjërat e nevojshme të cilat i përshtaten specifikave të Kosovës. Në koncept konsideroj se Qeveria e Republikës së Kosovës edhe në paraqitjet e saja ka qenë tepër e qartë që nuk është që të gjitha kompanitë të mbahen në pronë shtetërore. Që nga viti 2007 Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me dhënien e licencës së IPKO-së ka filluar ta humb tregun që është prit, dhe normal që është e natyrshme dhe të gjitha analizat të cilat janë bërë shihet çartë se në formën në të cilën është bërë, PTK do ta ketë të vështirë të konkurrojë në garën e ashpër të këtij sektori. Në të njëjtën kohë nevojat e qytetarëve të Kosovës, zhvillimi i teknologjisë ka bërë që PTK të jetë konkurrent karshi dinamikave të zhvillimeve teknologjike siç është edhe kërkesat e qytetarëve në produktet e reja të cilat janë BlackBerry, Smartphony, Apple, iPhone, të cilat produkte konkurrenca ka filluar ti lansoj që të gjithë. Në anën tjetër vlera e PTK në bazë të gjithë analizave po të shikohen të gjithë indikatorët ku ju do të shihni që nga 2005 e deri në vitin 2009 faktorët e rëndësishëm kanë pësuar rënie të konsiderueshme qoftë edhe hyrja e taksave qoftë edhe hyrja e prezantimeve në të hyra karshi IPKO-së apo trendeve të tjera në regjion. Që nga viti 2005 ju i shihni që nga 106 milion ka ra në 32 milion euro po ashtu edhe elementet tjera janë shumë të rëndësishme që të analizohen sidomos produktet e reja dhe koha në të cilat po zhvillohen privatizimet e reja në regjion siç është në Bosnje, Serbi, Bullgari si dhe në Ukrainë të gjitha ndërmarrjet e këtyre shteteve janë me nxitim duke kaluar në sektorin privat. Sipas disa të dhënave Serbia tani e ka hapur tenderin por vetëm 20% të aksioneve i ka privatizuar tani, do ti privatizoj edhe 70 % të tjera, Rumania i ka privatizuar më shumë se 80%, Turqia më shumë se 60%, Maqedonia më shumë se 70%, Kroacia në forma të ndryshme, Bullgaria më shumë se 70%, Mali i Zi me të njëjtën situatë. Pas analizave të cilat i kemi bërë janë sjellë tri opsione të strukturës së shitjes dhe komisionin ndërministror ka rekomanduar Qeverinë që të paktën 75% të aksioneve ti shet dhe arsyeja e mbajtjes të 25 %, dhe mendoj se në aspektin politik, do të jetë mjaftë e vështirë me menaxhua mbajtjen kaq të madhe të këtyre aksioneve sidomos kur dihet se pas transformimit pjesëmarrje e kësaj pjese do të jetë e vështirë për vendim marrje. Ndërsa në qoftë se jepet paketa më e vogël se 66% asnjë investitor nuk do të jenë të interesuar ose do të jenë shumë pak të interesuar. Një aspekt i veçantë ju është kushtuar çështjes së punëtorëve dhe ne konsiderojmë që ta marrim një pajtueshmëri siç patëm thënë për të gjitha ndërmarrjet më strategjike siç është edhe Aeroporti, PTK edhe KEK-u çështja e punëtorëve do të trajtohet me shumë kujdes edhe jemi duke i analizuar edhe opsionet që të paktën për tri vitet e ardhshme të kemi forma mirë të mbuluara legjitime që punëtorët të cilët kanë kontrata valide që mos të dëmtohen. Një element tjetër është që pjesa e Postës si pjesë e ndjeshme, nuk do të jetë pjesë e transaksionit, janë pjesa si të themi e akordimit të fundit qoftë si ligjore qoftë si rregullativë të ndajmë Postën nga Telekom, edhe ndaj Valës në mënyrë që blerësi i ardhshëm ta ketë të pastër sepse është shumë me rëndësi qartësia e investitorit.

Fatmir Rexhepi – tha se sot është debati i parë fillestar në Parlament, dhe është mirë edhe pse sipas fjalëve të ministrit po del tetori apo nëntori do të jetë koha kur përfundon kjo strategji lidhur me privatizimin e kësaj ndërmarrje, gjykoj realisht se nevoja që publiku të njoftohet, aq më shumë parlamenti, është më se e domosdoshme dhe kujtoj që kjo është po ashtu një vërejtje që është tepër e ngutshme në këtë fazë. Kam prit nga Qeveria që në planë të parë të mos na ofron strategjinë e privatizimit, ndryshimit të pronësisë të PTK-së, të një ndërmarrje më profitabile në vend. Sot kam pritë ta debatojmë

këtë, kam reaguar edhe në parlament, kam kërkuar edhe debat kam qenë i gatshëm që të marrë pjesë, sepse shumë më mirë të bëjmë mbikëqyrje, të ndërtojmë aso strategjie, aso drejtimi të menaxhimit që kjo kompani aq profitabile të mos privatizohet në këtë ambient ekonomik çfarë është sot sepse si deputet jam tepër i rezervuar se ka nevojë me kaq dinamikë me këtë ecuri me shkuar. Propozoj që në shtator të ipet një strategji si me u qeverisë kjo kompani profitabile, e cila ka mundësi të ketë të hyra pavarësisht konkurrencës e cila duhet të jetë në ekonomi të tregut, por të ndërtohet performancë e mirë, menaxhim i mirë dhe mos të ndërrohet pronësia kaq shpejt. Çështja e financimit që po përmendet të shesim pasurinë publike dhe të financojmë autostradën, edhe aty z.Minister nuk e ndaj mendimin e njëjtë. Mendoj që në këtë koncept Qeveria edhe Ju, duhet që keni alternativa tjera të cilat do të jenë më të frytshme, më të sigurta. Mendoj që nga fitimi i PTK-së, nga të hyrat tjera pra për 5, 6 vite me një dinamikë tjetër të kemi edhe financimin e ndërtimit të autostradës, nuk është për ngutë faza e dytë e autostradës prej Prizrenit deri në Prishtinë, nuk është për ngutë të ndërtohet brenda një viti ose dy vite, më mirë është 5, 6 apo 7 vite sikurse kanë bërë edhe vendet tjera, edhe pastaj qoftë nga profiti qoftë nga kreditë e buta qoftë nga format e tjera të financohet ndërtimi i autostradës. Realisht pra të kemi për 5, 6 vitet tjera edhe PTK-në në pronësi me një performancë të mirë të kemi edhe autostradën por të kemi pra edhe mundësi të tjera zhvillimi që këto mjete të tjera në fusha tjera, pra investimet kapitale të mbesin në ato drejtime ku edhe ju i keni planifikuar në kornizën afatmesme dhe në fushat tjera që do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit. Prandaj kërkoj nga Qeveria që ta shqyrton mundësinë që të na sjellë një strategji për menaxhimin e mirë të PTK-së edhe mos të ngutemi ta ndërrojmë pronësinë sot sepse pa pronë kemi me mbetë lehtë por me kthyer nuk mundemi më kurrë.

Múfera Şinik – siç dihet për Kosovën privatizimi i PTK-së, është një temë shumë e rëndësishme, po ashtu siç jemi njoftuar nga ministri me privatizimin e PTK-së do të përkrahet edhe buxheti i shtetit të Kosovës. Kosova është një shtet jo i zhvilluar, dhe për zhvillimin e Kosovës duhet të punohet sa ma shumë. Deri sot PTK-ja si kompani publike, proceset e prokurimit publik, qeverisen nga rregullat strikte të prokurimit publik, shihet së të ardhurat në një kohë shumë të shkurtë janë zvogëluar tri herë. Nëse i krahasojmë shtetet në rajon Bosnja, Serbia, mendoj që edhe Kosova duhet të jetë në këtë rrjet. Shtroj pyetje për ministrin: si do të jetë gjendja e punëtorëve, të cilët punojnë në PTK pas privatizimit?

Adem Salihaj – paraqiti vërejtje në procedimin materialit më vonesë sepse është mjaft voluminoz, dhe koha prej dy ditësh është mjaft e shkurtër për ta analizuar dhe kur behët fjalë për një temë të rëndësishme së lartë siç është në këtë rast privatizimi i PTK-së. PTK-ja është ndërmarrja më profitabile që i sjell ndoshta më së shumti para prej ndërmarrjeve publike, buxhetit të Kosovës, edhe vet PTK-së. Dhe kam shumë dilema lidhur me propozimin dhe strategjinë për privatizim, tha zoti Salihaj. Paraprakisht ju informoj se partia të cilës i takoj unë, ka qëndrim që të përmbahemi nga votimi për Strategjinë e Privatizimit, për arsye se nuk është analizuar sa duhet, dhe neve na duhet kohë që të bëjmë analiza të sakta se a është në interes të Kosovës apo nuk është që të privatizohet PTK-ja. Ngrii çështjen dhe kërkoj sqarim nga Ministri, për një telefoni të re mobile “Z Mobile – 045” që në fillim e kemi kuptuar si pjesë të Valës, pra si pjesë të 044, sepse

mbushjet shërbejnë për të dy numrat 044 dhe 045. Ndërsa në marketing thuhet që është telefonia më e re mobile në Kosovë, dhe kërkoj sqarim për çka është fjala, është një telefoni tjetër apo është pjesë e valës? Dhe a është e njëjta telefoni që kemi pas deri më tash. Dhe çështja tjetër është se Vala ka njëfarë lloj monopoli në telefoninë mobile, ka 91% të tregut krahasuar me IPKO-n që ka vetëm 9%, dhe përsëri pyetja është se pse neve na duhet privatizimi ose shitja e PTK-së respektivisht e Valës, që ka ende një monopol të themi në tregun e Kosovës? Janë çështje për të cilat ne kemi nevojë për kohë, kemi nevojë për analiza dhe pasi ta bëjmë këtë ne do ta kemi edhe qëndrimin tonë lidhur me këtë. Në fund tha se sot ka qëndrim të përmbytur lidhur me strategjinë e Qeverisë për shitjen e PTK-së.

Kryetarja – tha se duke marrë parasysh se pas Vendimit të Kryesisë, e cila kërkon nga Komisioni parlamentar për shqyrtimin e Strategjisë së Privatizimit të PTK-së, është shqyrtuar më datë 29.06.2010, neve si Komision materiali na është shpërndarë diku të hënën më datë 05.07.2010, dhe të gjithë deputetëve, por edhe mua si Kryetare e Komisionit.

Ethem Çeku – mund të paraqitet një nga çështjet më të ndjeshme mbas diskutimit që kemi pas se a duhet të privatizohet KEK-u, Distribucioni, Kosova e re, tani në radhë po vjen njëri nga gjigantët e zhvillimit ekonomik të Kosovës siç është PTK-ja tha zoti Çeku. Realisht për mua është tepër me interes politika zhvillimore, si ndikon në zhvillimin e shtetit ndërhyrja e kapitalit apo investimet e kapitalit privat në këtë drejtim. Duke ditë se ne kemi një buxhet të varfër, një zhvillim ekonomik të ngadalshëm, shkalla e zhvillimit dhe zhvillimi në përgjithësi i vendit tonë është një nga trendët e vogla që nevojitet që Kosova të del nga një krizë ekonomike. Cili është vizioni i Qeverisë si do ti përdor mjetet e privatizuara nga PTK-ja, për zhvillimin ekonomik të vendit. Problemi i dytë është çështja ligjore. A keni të përgatitur infrastrukturën ligjore për të ndërmarrë një hap të tillë? E dimë që jemi duke bërë shumë diskutime për reformimet, ristrukturimet e ligjeve dhe ridraftimin, por është problem shumë i madh në këtë drejtim, projekti ec, dhe çështjen ligjore a e kemi harmonizuar, a po ec projekti sipas vijës ligjore? Problemi tjetër është përfitimi shtetit të Kosovës nga privatizimi i PTK-së. Cili është ky koncept çka arrin shteti me privatizimin e PTK-së. Nuk dua të mohoj i kemi dy koncepte një që e prezantoi ministri, që e ngrit konceptin që privatizimi sjell shumë të mira dhe një i cili është i përfaqësuar nga sindikata dhe institucione tjera të cilat thonë se privatizimi nuk i sjell ndonjë të hyrë të mirë shtetit të Kosovës. Një problem tjetër është çështja e numrit të madh të punëtorëve, u dëgjua ministri se edhe me privatizim do të tentohet, që për mua është një pikpyetje e madhe në këtë drejtim që të ruhen vendet e punës dhe format e tjera. Si Komision, si institucion, si parlament, si qeveri ta kemi shumë më tepër hapësirën për me diskutuar për këto projekte të mëdha që kanë të bëjë me çështjen e privatizimit dhe çështjen e transparencës në këtë drejtim. Parimisht ne mbështesim ndërhyrjen e kapitalit privat ndërlidhshmërinë e kapitalit privat, por duhet të shohim në radhë të parë interesin e shtetit dhe konceptin se si mund të përdoret buxheti për zhvillimin ekonomik të vendit, a ndikon kjo drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik apo një strukturë të madhe po e vendosim në një strukturë në të cilën për kohë të gjatë do të kërkohej që të kthehet në favorin e zhvillimit ekonomik të vendit. Kam shumë pikpyetje në këtë drejtim që duhet të diskutohen që krijimi i këtij fondi nga privatizimi për orientim në autostradë, në çështje

sociale dhe në çështje tjera. Dua të sjellë përvojën e dy Qeverive të kaluara, kemi ndarë buxhet të jashtëzakonshëm për çështjen e anës sociale dhe në shumicën e rasteve nuk na kanë rikthyer në projektet të cilat Kosova duhet të del më në fund nga vendi i fundit në Evropë për të ardhurat për kokë banori. Prandaj, të sjellim konceptet se çka sjell privatizimi në këtë drejtim, dobëson shtetin e Kosovës në aspektin financiar, ekonomik, zhvillimor apo e përkrah apo e mbështet zhvillimin ekonomik, që për mua këto janë dy pikëpyetje dhe udhëkryqe të mëdha, tha zoti Çeku. Çështja tjetër është në qoftë se flasim për kriza globale, në qoftë se thojmë çështja e privatizimit, ndërtimit të termocentralit Kosova e re, nuk ka mund të bëhet për shkak të krizave globale, nuk po mund të kemi oferta të mira, për PTK-në po lind koncepti se ka mundësi edhe në kriza globale të bëhen hapa të caktuar.

Qamile Morina – vlerësoj dhe iu bashkëngjijtë deputetëve parafolës se privatizimi i PTK-së, është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm për kahjen që do të merr zhvillimi ekonomik i vendit. Gjithashtu edhe unë pajtohem që materialin e kemi marrë me vonesë mirëpo ajo që për mua hapë shumë dilema ka të bëjë me komisionin ndërministror që është formuar në vitin 2008. Dhe sot deklarohet nga ministri se jemi të barabartë në bazën e informacionit. Z.minister nëse ju keni filluar me planifikuar privatizimin e PTK-së në vitin 2008, pse ne e kemi sot strategjinë me 22 Qershor 2010? Vendimet janë marrë për privatizim dhe ne strategjinë e kemi sot post-festum në Kuvendin e Kosovës. Besoj që ky komision ndërministror ka pas për detyrë edhe objektiv të krijojë parakushte për fillimin e këtij procesi, krijimin e situatave të favorshme përgatitjen e bazës ligjore për të cilën sot të gjithë kemi vërejtje që nuk e kemi, krijimin e koncenzusit bazë në mes të akterëve relevant dhe transparencës maksimale, e cila nuk ka ekzistuar, por ne sot po merremi me te. Çështja është së qytetarët e Kosovës, vlerësoj që nuk e kanë ditë se çka do të përfitojnë dhe cili është benefiti i tyre. Të gjitha të dhënat na tregojnë që PTK-ja nuk ka qenë barrë për buxhetin e Kosovës, në të vërtetë i ka sjellë mjete buxhetit të Kosovës, në vitin 2009 kemi dividendën prej 200 milion eurove, në fillim vit 85 milion, PTK-ja ka sjellë donacione prej 3.5 milionëve, kanë qenë lavdatat e juaja kur janë bërë pranime dhe punësime shumë në vitin e kaluar që kjo organizatë punon me sukses. Prandaj janë edhe studimet e UNDP-së në dhjetor të vitit 2009 ku PTK-ja thuhet operon në mënyrë të efektshme është produktive dhe ofron shërbime me kualitete të larta dhe kënaqëshmëri të lartë të konsumatorëve. Do të thotë këto janë disa të dhëna që ne na bëjnë të dyshojmë që përfitimi i këtij privatizimi a do të jetë në favor të Kosovës e në favor të qytetarëve. Çështja tjetër është që gjatë privatizimit nuk është bërë ndarja mes Telekomit dhe Postës, që duhet të bëhet në mënyrë shumë rregullative ndarja e Postës. Posta edhe shërbimet postare nuk janë në asnjë vend profitabile jo vetëm tek ne. Posta në raportin e juaj i ka të hyrat e përgjithshme 1.5% kurse 17.5% keni të punësuar edhe kjo tregon që kur të mbetet posta, do të jetë barrë për buxhetin e Kosovës. Shtrohet pyetja këto përfitime që i kemi pas kaq vite prej PTK-së a do të kemi ne përfitime? A do të jenë ato shumë minimale edhe a do ta kemi na barrë Posten? Kush do të jetë bartësi i përgjegjësisë që do ta kryejë këtë punë? Ne jemi dëshmitarë që procesi i privatizimit i ndërmarrjeve shoqërore është fiasko, sepse te ne nuk ka llogaridhënie prandaj ne duhet të jemi të kujdesshëm kësaj radhe të mos hyjmë pa kokë në çështjen e privatizimit të PTK-së.

Zef Morina – tha se mendon që prezantimi nuk e ka qëllimin e dhënies së fjalës së

fundit, por marrjen e informatave nga Qeveria lidhur me strategjinë për privatizimin e PTK-së. Dëshiroj që të fitohet përshtypja nga të gjithë këtu, që jemi për hyrjen e kapitalit të huaj në Kosovë për shkak që dihet se në çfarë gjendje është Kosova, pavarësisht që PTK-ja është sektor i vetëm që është profitabil në Kosovë. Kam përcjellë PTK-në prej vitit 1999 e deri tani sepse kam qenë pjesë një kohë si bashkëdrejtues mandej si minister dhe tash si deputet dhe vërtetë ka ngritje dhe rënie nga momenti në moment i disa sektoreve. Këtu duke përfshirë telefoninë fikse në të cilën shumë pak ka pas investime nga PTK-ja, ngritje shumë të dukshme ka pas në sektorin VALA gjegjësisht në telefoninë mobile e cila vërtetë i ka dhënë një forcë ekonomike gjithë PTK-së. Është e vërtetë që pas dhënies së licencës për operatorin e dytë të telefonisë mobile ndoshta Vala nuk e ka pas ritmin e ngritjes që e ka pas deri në atë kohë, por sido që të jetë të gjithë jemi dëshmitarë dhe të gjithë e dimë që PTK-ja në përgjithësi ka qenë dhe është kompani profitabile. Ajo që më së shumti duhet të analizohet është pse po bëhet privatizimi anët pozitive për shtetin dhe brengat të cilat mund të lindin qoftë tek sindikata qoftë tek punëtorët qoftë edhe tek qytetarët. Dëshiroj që së pari nga ana e qeverisë por edhe nga kolegët të përmbahemi nga disa prononcime të cilat nuk janë, apo mund të mos jenë reale pa shikuar mirë materialin, pa e lexuar mirë strategjinë, dhe thjesht pastaj ftoj që gjithë bashkërisht të japim një mendim i cili do të jetë në interes të vendit, duke pas parasysh se ne jemi të orientuar nga Evropa dhe duhet patjetër të veprojmë sipas një rregulli që bashkërisht do ta kemi.

Kaqusha Jashari – tha se privatizimin nuk mund ta ndalim, se privatizimi ka marrë rrugën e vet, dhe privatizimi i PTK-së me siguri vjen në rend, por mendoj se privatizimi i këtij sektori pronës shtetit d.m.th. ndërmarrjeve publike duhet të jetë aq sa është në pyetje edhe efikasiteti, sikurse edhe ministri që e tha, funksionaliteti dhe futja e teknologjisë së re. Por shitja e aksioneve të ndërmarrjeve publike duhet me qenë me shumë kujdes edhe me shumë analizë shumë diskutime, edhe të shoqërisë civile, edhe qarqet akademike por gjithashtu edhe në institucione. PTK-ja është një prej kompanive profitabile, edhe një paraqitje e ministrit, edhe në opinion se duhet të nxitojmë se ma vonë është më lirë në qoftë se privatizohet, tash aksionet janë më të shtrenjta, mendoj që duhet me pas shumë kujdes. Dilema janë në atë se në fillim të këtij materiali thuhet se në shumicën e vendeve Posta është ende në pronësi shtetërore, prandaj edhe më parë e kam diskutuar edhe në parlament, nuk jam prej atyre që duhet me shkuar me një përqindje aq të ultë përqindja e cila është e propozuar 25%, duhet të kemi kujdes pse Posta duhet me qenë një pjesë më të madhe të pronësisë së shtetit. Mendoj që Posta ani pse janë shënime shumë të qarta nuk është profitabile po me këtë organizim të cilën e kemi Telekomin, Postën, ka mbuluar nevojat sepse të hyrat janë shumë të vogla të Postës. Këtu gjithashtu thuhet privatizimi i Postës së bashku me Telekomin nuk është tipik por jo i pamundur, e pse ne me provuar kur nuk është tipik? Duhet me analizuar edhe plus një arsye shumë të madhe që ne të bëjmë diçka që është e pamundur të bëjmë të mundur. Gjithashtu edhe ky Vendim i Qeverisë që nuk duhet të shtohet numri i punëtorëve, është shtuar aq shumë pas luftës sa që është bërë ndoshta e pamundur me i mbuluar të gjitha ato shpenzime, por ajo ka qenë marrëveshja. Gjithashtu është edhe një prej klauzolave një prej vendimeve që operatori i tretë nuk mund të futet 5 vite, edhe ne kemi shumë kujdes për ata që privatizojnë edhe e marrin pjesën e PTK-së, të kemi një mendim që nuk mundet me hy operatori i tretë pse kanë duhet ta ruajmë ne këtu. Këtu ka një analizë sa ka dëmtuar Ipko Valën, por a jemi

për tregun e lirë dhe konkurrencën, po e pse ta ndalojmë edhe operatorin e tretë që të hyjë në tregun e lirë. Janë disa çështje që unë nuk e kontestoj nevojën për privatizim, por e kontestoj mënyrën edhe nxitjen patjetër, tha në fund znj. Jashari.

Adem Grabovci – tha se jemi dëshmitarë të gjithë në kohët e fundit gjatë kemi luftuar dhe kemi qenë të angazhuar të gjithë që të fillojë procesi i privatizimit në vend dhe këtë e kemi arritur. Tjetër, ne jemi përcaktuar shumë qartë për ekonominë e lirë të tregut, dhe kjo nënkupton fillimin e këtij procesi për konkurrencën në vend. Jemi të gjithë të shqetësuar për zhvillimin ekonomik të vendit tonë, trendet e këtij zhvillimi jo të kënaqshëm dhe besoj se jemi të gjithë të vetëdijshëm se nuk mund të bëhet fjalë për një zhvillim të hovshëm ekonomik pa depërtimin e kapitalit të huaj brenda vendit, do të thotë pa sjelljen e investitorëve potencial në vend dhe a mund të kemi investime dhe kapital nëse ne mbyllemi në vetveten, përgjigjja është shumë e qartë jo. Prandaj për mua ka qenë edhe një rrjedhim logjik se një ditë do të vijmë me fillimin e procesit të privatizimit edhe ndërmarrjet publike të cilat duhet të hyjnë në këtë proces të privatizimit. Është çështje tjetër se do të fillojë më herët apo më vonë. Trendet e zhvillimit në PTK janë negative, ne po e sjellim vetëm një informatë që e kemi këtu përpara të gjithë nëse nuk e keni strategjinë e kemi materialin që e morëm sot, nëse në vitin 2007 të hyrat kanë qenë 250 milion në vitin 2009 kemi një rënie të hyrat janë 120 milion euro. Në anën tjetër përvojat e vendeve në rajon që janë thirr në strategji japin të kuptojnë se nëse ne presim, nëse operatori Ipko kur kemi lejuar konkurrencën ka ndikuar negativisht në rënien e aseteve gjegjësisht të hyrave të PTK-së – Valës. Atëherë operatori i tretë në të gjitha vendet ku ka ndodhë kjo ka ndikuar negativisht dhe kanë pësuar rënie operatorët tjerë. A duhet ne që të presim të zhvlerësohet Vala, gjegjësisht Post-telekomi dhe pastaj ne të hyjmë në privatizim të saj? Dhe duke pas parasysh edhe shumë arsye tjera që PTK-ja është e domosdoshme ti nënshtrohet procesit të privatizimit. A jo që ne duhet të kërkojmë dhe shihet qartë se Qeveria është e përcaktuar shumë drejt dhe qartë për me hy në këtë proces transparent që e ka karakterizuar edhe shumë raste të tjera, aeroporti etj. Shqetësimi kryesor është fati i punëtorëve, këtu Qeveria duhet të udhëheq një politikë shumë të kujdesshme, të mendojë dhe të ndërtojë të merr disa vendime që vërtetë të mendohet drejtë për fatin e punëtorëve që vërtetë do të shkojë ky proces. Kërkoj që mos të lejohet që punëtorët në PTK, që është një numër shumë i madh që nëse lejohen të hedhën në rrugë do të na shkaktojë një krizë sociale dhe për këtë mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të udhëheqë një politikë shumë të drejtë. Nuk them këtu as në emër të grupit se do të kem këtë apo atë qëndrim, ne do ti analizojmë përsëri në grupin parlamentar dhe në institucione përkatëse sepse kjo strategji dhe nëse e shohim të nevojshme do të dalim me ndonjë propozim apo zgjidhje të re tha në fund zoti Grabovci.

Sala Berisha – Shala – tha se ne në kuvendin e Kosovës e kemi miratuar një ligj për ndërmarrjet publike, dhe bëj ftesë deputetëve që ta analizojnë dhe të shihet se Qeveria është duke punuar krejtësisht në suazat e ligjit të cilin e kemi miratuar ne në Kuvend. D.m.th ka filluar debati, është strategjia dhe ligji e obligon Qeverinë ti hyjë kësaj strategjie. Dolën shumë shqetësime, shumë natyrshëm por një ndër tjera ke një shqetësim se po shiten pronat ndërmarrjet publike dhe ne po mbesim pa asgjë. Përsëri po thirrrem në ligjin për ndërmarrjet publike, ku thuhet se Qeveria është aksionare në ndërmarrjet publike, dhe kemi obligim institucional që ta vëzhgojmë me mikroskop hapat e Qeverisë,

a po del jashtë ligjit apo jo, ajo çka e lejon Qeveria. Ne e kemi diskutuar në këtë Komision parlamentar edhe në mandatin e kaluar në bazë të raporteve që i ka sjellë ART-ja në Kuvend, çmimet e telefonisë mobile në tregun e Kosovës kanë qenë më të shtrenjta në rajon, raporti ka qenë 1/9. Prandaj ne si tërësi duhet ta analizojmë këtë çështje e jo vetëm si një segment të caktuar, por në qoftë se i diskutojmë si tërësi që janë në rrjedhën e duhur dhe janë pozitive hapat që po i merr Qeveria në këtë rast edhe ne si deputet duhet ti mbështesim aty ku konsiderojmë se vërtetë është ka shkon në rrjedhën e duhur.

Naim Rrustemi – tha në Komision edhe në Kuvend kur sjellët një strategji ndoshta ka nevojë me u vendosë në terma pak ma konkret, mos me mbet vetëm në terma abstrakt. Strategjia sjell shumë të mira por sjell edhe shumë probleme që Qeveria deri më tani është krenuar me to, është hera e parë që ne dëgjojmë diku që Qeveria nuk ka arrit me menaxhuar mirë. Të gjitha të dhënat nga kjo strategji tregojnë se kemi një zvogëlim shumë të madh të vlerës së PTK-së. Tani për tani PTK-ja EBTDA e ka 58.4 dhe ata që e njohin fushën e telekomit e dinë që është komponentë kryesore për vlerësimin e një industrie të telekomunikacionit, sepse faktorët me sa shumëzohet EBTDA varet shumë prej zhvillimit ekonomik krizës globale e prej shumë faktorëve tjerë. Në atë moment kur EBTDA e kemi 58.4, ndoshta me një menaxhim më të mirë mundesh me e vonuar për një kohë tjetër sepse spo dua me tingëlluar sikurse domosdoshmërisht jemi kundër privatizimit, askush nuk po e thotë atë por ne po kërkojmë kohën ma optimale kur me u fut në privatizim. Se privatizimi veç një punë e ka me maksimizuar profitin se juve po ju nevojitet paraja ti identifikon çka po donë me shitë edhe e shet edhe shumë e vërtetë është që 2004 ka filluar me ra EBTDA edhe që atëherë janë bërë hapat e parë për me përgatitë PTK-në. Kurse në strategji kemi shumë referime në ARPU-n, ARPU-ja është një mesatare sa shpenzojmë para ne telefon, ajo varet shumë nga zhvillimi ekonomik, edhe kjo është përsëri një e keqe për Qeverinë sepse spo kemi pare me harxhuar. Kërkoj nga ministri që kur ta sjellë Raportin e tillë në Kuvend më shumë me u referuar në EBTDA -n që është komponentë shumë më e rëndësishme në privatizimin e industrisë së telekomit, shumë e rëndësishme është edhe ARPU-ja, por nuk është me aq peshë sa EBTDA. Normalisht që e keni edhe numrin e punëtorëve që reflekton drejtpërdrejt në çmimin final sa ka me u shit Vala, edhe faktorë tjetër ky raport tregon që shpenzimet janë rrit shumë deri 2010, çka reflekton kjo shpenzimet janë rritë shumë EBTDA, me fjalët e tjera është barazi me menaxhim të keq. Kërkesat për me privatizuar në këtë moment janë kërkesa që kanë filluar pikërisht në 2008 me zvogëluar vlerën të vetmit aset që kemi të vlefshëm në Kosovë. Gjithashtu ata që kanë shkruar këtë është mirë me tregu me i thanë disa fjalë, që Dardafone dhe Dardafone.net, ku aferën e kemi të hapur është çështje legale. Edhe 25% i PTK-së ka erdh ky numër? Në tabelë të kësaj strategjie vetëm një mangësi e ka qindëpërqindëshi; 67% e më shumë i keni listuar 10 mangësi; 100% ja ke listuar një mangësi edhe po del ky me 7 mangësi më i mirë se ky me 1 një mangësi, ska kuptim por ua shpjegoj sepse shthurja ligjore kurrkund skapet, ka mbetur hapur qysh bëhet privatizimi i mobilit edhe telekomit, pa u bërë shthurja ligjore e njësive po me mbajtë 25% me diktuar shthurjen pas privatizimit. edhe atëherë edhe manipulon me 25%. Për me shthur, në algoritëm është këtu në fjalë e juaja, pse mos të bëhet shthurja ligjore tani edhe shthurja financiare, pse mos me u shthur njësitë brenda PTK-së, njëherë le të shthuren edhe atëherë ka më pak hapësirë për manipulim.

Milazim Alshiqi (Sindikata e PTK-së) – tha se Sindikata e PTK-së në rastin e marrjes së informatës se do të privatizohet PTK-ja, ka organizuar një takim i ka dërguar delegatët dhe në atë Kuvend të delegatëve ka marrë vendim të nënshkruhet një peticion kundër privatizimit të PTK-së, dhe ai peticion ju është dërguar të gjitha instancave relevante vendore edhe ndërkombëtare në Kosovë. Në atë peticion është kërkuar që Sindikata e pavarur e PTK-së është e shqetësuar për kompaninë në privatizim dhe duke u bazuar në përvojat e deritanishme të privatizimit kërkon që krizën financiare globale, duke u bazuar që Republika e Kosovës nuk ka kod shtetëror, nuk është barrë e Qeverisë por përkundër e ndihmon Qeverinë e Kosovës, që të ndërpritet procesi i privatizimit deri sa të zbatohet Ligji i punës, Ligji mbi veprimin sindikal nga Kuvendi i Kosovës. Kur flasim për procesin e privatizimit mendoj se PTK-ja e meriton një kujdes shumë të veçantë me vetë faktin se ka afarizëm të mirë, është një ndërmarrje e cila e ka ndihmuar Qeverinë dhe duhet që në këto kushte gjithsesi të shtyhet procesi i privatizimit. Sepse të gjithë e dimë se çka donë të thotë fjala privatizim pra na duhet një kujdes dhe një përgaditje shumë më e mirë për një ndërmarrje, por kur ka afarizëm të tillë siç ka PTK-ja , atëherë pse është kjo nguti. Ne kemi raporte të mira me shtetet fqinje ndërsa Bosnja dhe Hercegovina e ka pasur iniciativën për privatizim në vitin 2006-të. Sa i përket bisedës të Ministrit kur tha se sa e ka pasur ndërmjetësime sindikata, këtu i nderuari i transaksionit na ka ftuar këtu si dhe sindikata e PTK-së e ka prezantuar këtu peticionin që e kemi kundërshtuar privatizimin kemi pasur edhe dy apo tri takime po mund të them se ne u kemi dorëzuar dokumentacionin njerëzve që e udhëheqin shtetin në nëntor të vitit 2009. Mund të them se nëse vjen deri te kriza, sindikata nuk mund të garanton, jeni dëshmitar se rastet sociale janë rritur në rastin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe kush e muar përgjegjësinë prej njerëzve të Kosovës, se çka u bo me 20 %-in. Dhe në fund tha se duhet ta marrim me seriozitet dhe ne kemi ekspertë vendor si edhe ndërkombëtar të cilët kanë mundësi me na ndihmuar shumë që procesi i privatizimit të bëhet në mënyrë shumë analogjike si dhe të bindet ky popull pse po bëhet privatizimi dhe nuk duhet të keqkuptohet që jam kundër privatizimit nuk duhet të keqkuptohet se jam në mendje se privatizimet nuk janë të mira por duhet njerëzve të ju ipet një shans ta thonë atë se çka mendojnë për privatizim.

Emrush Xhemaili – pyeti se a ka mundësi për nevojat për të cilat u fol për autorrugën, për nevojat sociale, që të plotësohen sipas propozimit të PTK-së? Sepse ndoshta jeni në dijeni apo ndoshta nuk jeni se atëherë Posta e potencoj se është e gatshme që të jetë garant, në garancat bankare në rast se ju merrni kredi, posta ti mbulojë edhe për nevojat e rrugës. Kështu që për çdo rast ka nevojë që të shkojmë hap pas hapi të gjithat vendet nuk kanë bërë privatizime me përqindjen të cilën jeni ju duke e kërkuar dhe është gjë të cilën ne të gjithë e kemi dëgjuar, se askush nuk po hyn mbi 65% ose 60% në privatizim por ne gjithsesi duhet ta shikojmë Postën dhe kronologjikën edhe interesin e shtetit për këtë jo tjera arsye të interesave politike, ideologjike që ne po dëgjojmë këtu.

Kryetarja - duke e marr parasysh se me kërkesën e Komisionit Parlamentar dhe në bazë të Rregullorës së Punës së Kuvendit, ministri është i obliguar që të vijë të raportojë në Komisionin Parlamentar; dhe duke e marr parasysh që Komisionet parlamentare përbëhen nga përfaqësuesit të zgjedhur të popullit ne e mirëpresim bashkëpunimin Ministri Kuvend; duke e marrë parasysh dhe esencën që të kemi një bashkëpunim shumë të mirë për çështjet madhore si p.sh siç është rasti i strategjisë së privatizimit të PTK-së;

duke marrë parasysh se është një aset i qytetarëve të Kosovës që menaxhohet në bazë të Ligjit të Ndërmarrjeve publike nga Qeveria e Kosovës në strategjinë e cila është sjellë në Kuvendin e Kosovës, ministër këtu shoh përqindjen e aksioneve në shitje, dhe shoh 5 opsione. Mirëpo mund të them se kjo strategji është në opsion i parë brenda Komisionit Parlamentar dhe ka mundësi që çdo gjë në rast se Kuvendi është organ i zgjedhur i qytetarëve të Kosovës, dhe qytetarët janë ata të cilët janë në PTK dhe të merren plotësim ndryshim i strategjisë me opsionet e deputetëve brenda Kuvendit të Kosovës, atëherë do të shikojmë se cilat opsione janë më të mira. Ndërsa në faqen 28 më vjen shumë keq të gjitha këto opsione binë me një herë, se thotë: vendimi për strategjinë e privatizimit plani ndërmarrës qershor 2010-të, miratimi për miratimin për strategjinë e privatizimit të PTK-së, qershor – korrik 2010-të, inicimi i parakualifikimeve të investitorit për privatizimin e PTK-së, Komisioni për privatizim korrik 2010-të, inicimi i kërkesave për privatizim, Komisioni për privatizim java e parë shtator 2010-të, dorëzimi i ofertave nga ofertuesi, Qeveria investitori nëntor 2010-të, nënshkrimi i marrveshjes së blerjes së aksioneve Qeveria investitori është java e parë e dhjetorit 2010-të, dhe përmbyllja shkurt 2011-të. Ku atëherë do të thotë se i gjithë diskutimi është i kotë në rastë se kjo pasqyrë e tregon fillimin e procedurës dhe të mbarimit, atëherë është e kotë i gjithë diskutimi duke e marrë parasysh se konceptin e privatizimit në PTK-së dhe futjen e kapitalit në PTK-së askush nuk është kundër kësaj pavarësisht pozitë apo opozitë. Sepse Kosova është e të gjithëve dhe çka mund të bëjmë të gjithë është esenca se çka mund të bëjmë për Kosovën. Mirëpo qasja se si do të hy ky kapital në privatizim kur dihet se ndërmarrjet publike jo vetëm nga kjo Qeveri, duhet të jemi shumë transparent edhe dy Qeveritë e kaluara janë udhëhequr politikisht dhe janë menaxhuar politikisht, dhe këtu është esenca që ne kërkojmë që të rritet vlera e kompanisë në momentin e fundit. Mirëpo vlera e kompanisë nuk rritet në momentin e fundit kur nuk ke bërë menaxhim që nga fillimi të marrjes së pushtetit e deri më ditën e sotit kur ke insistuar dhe e ka në plan çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Shtrohet pyetja se çka përfiton Kosova në çështjen e privatizimit pa një infrastrukturë të plotë ligjore dhe çfarë ambienti është? Kur dihet se e gjithë Evropa është duke u ambientuar, nuk e di se çka do të përfitojmë apo vetëm mbulimin e koston të autostradës. Sinqerisht ky është gabimi më i madh për ne si deputet edhe për ju si institucion, dhe për këtë arsye është lexim i parë ndoshta i strategjisë brenda Komisionit Parlamentar, të shqyrtojmë për të mirën e saj ose kjo bjenë, në faqen tetë ku thotë se ne diskutojmë së koti dhe kjo do të thotë se kjo çështje është vetëm e përfunduar.

Ahmet Shala, ministër i Ekonomisë dhe Financave – u përgjigj në pyetje të deputetëve si në vijim: mund të them në parim mbështetjen dhe kjo ishte për mendimin tim një konkludim i përbashkët dhe sigurisht që Komisioni do ti nxjerr konkludimet e veta por kështu të paktën sa mund me e përmbledh. Çka është me rëndësi u ngritën shumë tema për të cilat ja vlen, fatkeqësisht që Kosova nuk ka qenë shtet i pavarur deri me 17 shkurt dhe kushtetuta e saj nuk ka hy në fuqi deri me 15 qershor përndryshe interesat e Kosovës do të ishin në çështje për të privatizuar se sa tani; Shtrohet pyetja në këtë trend të humbjes së kohës të Kosovës që u dhanë shifrat që nga viti 2007 deri në vitin 2009-të a do të mund Posta në këtë format që e ka me këtë kapacitet që ka në këtë struktur qoftë menaxheriale apo të punëtorëve në qoftë kapaciteteve të veta që i ka të konkurroj me gjigantët do të jetë një pyetje shumë e qartë dhe shumë e saktë nga çdo kush që e shikon nga këndvështrimi profesional nëse e ka analizuar mirë përgjigjja do të jetë vështirë apo e

pa mundur për shumë arsyeje jo politike aspektet e preukorimit; Ligji i prokurimit akoma nuk është Ligj i veçantë dhe neve do të na informojnë në Kuvend sa më shpejtë; dhe janë shumë faktorë dhe askush nuk duhet ta ndiej veten të ofenduar as menaxhmenti, e as sindikata, as askush dhe konsideroj se është bërë gjithçka që është e mundur është e vërtetë se PTK-ja është stërngakruar me punëtorë kanë pasur fat ata të cilët janë duke punuar aty për kriteret dhe punësimet e të tjera konsideroj nuk do të duhej të përziheshim neve shumë si Qeveri; edhe stërngarkimi me punëtorë e ka pasur të mirën e vetë në kohën e vetë por a mund ta bartë 3200 vetë karshi konkurrencës nuk do të mund ta mbajë nuk do mund të vrapoj me shpejtësinë; Qeveria e Kosovës pas analizave edhe u tha pesë Ministra kanë punuar në këtë dhe jam vetëm një nga të barabartit me Ligj dhe kanë konstatuar se këto pesë opsione që janë ofruar njëra prej tyre të rekomandohet; ne jemi dakord me fjalën pse u muar 75% pse nuk u muar 100%, ku e ka atë të metë; thashë më herët edhe që arsyeshmëria politike është e vetmja arsyeshmëri që sugjeron që Posta të privatizohet më pak se 100%, të gjitha argumentet ekonomike janë në favor të një porcioni sa më të madh të aksioneve për privatizim; asnjë investitorë i rëndësishëm nuk do të preferonte ndonjë paketë më të vogël se sa paketa vendimmarrëse, nën dy interesi i shtetit të Kosovës në këtë situatë karshi presioneve edhe sociale edhe për nevojat të investimeve infrastruktura është që nga PTK-ja të ketë të hyra maksimale për buxhetin e Kosovës, për realizimin e projekteve të veta të karakterit nacional edhe atij social dhe që ti ruaj me gjithë atë një paketë vote relevante 25% për arsye qoftë të drejtave të punëtorëve, qoftë për investimet në sektor apo elementet e tjera që në bazë të praktikave të shumta është dalë që është e dobishme; ne mund të vejmë edhe kohë më të shkurtër, por sa më e gjatë të jetë koha e operimit për operatorë çmimi i ofertuesve do të jetë më i lartë dhe shtrohet pyetja se a duhet të kemi në çmim më të lartë tani të PTK-së apo mbas pesë vjetëve apo mbas tri vjetëve, në qoftë se e vejmë një kohë për operatorin më të shkurtër kushdo që ta ofertojë do ta ofertojë më një çmim më të ulët; është bërë e ditur se ndërtimi i autostradës do të ketë një rritje të GDP prej 2 deri në 3 % cila do të jetë më e shpejtë rritja ekonomike në Kosovë; treguesi kryesor është etika ku u tha në fillim se është 58.4% është shumë e ulët por ajo do të jetë por ajo do të jetë edhe më ulët sipas trendëve dhe zhvillimit që ka tani; shpenzimet mesatare për njësi të huaja tregon gjendjen ekonomike në këtë vend përafërsisht që ART-ja tregon se sa përafërsisht; lidhur me shthurjen se a duhet bëhet paraprakisht apo jo neve i kemi bërë të gjitha përgatitjet që duhet bërë që PTK-ja pjesa e Postës, duhet të analizohet në mënyrë që të mbetet pronë e shtetit për shumë arsye por edhe për një ndër arsyet është se tani për tani se trendët në telekomunikacion janë që kryesisht po bashkohet telekomu, ndërsa Posta mbetet kryesisht pjesë në të cilën mund të zhvillohen disa aktivitetet edhe jopostare siç është Post banka që ka qenë një koncept në tavolinë ku konsideroj se për arsye të ndryshme nuk është zhvilluar dhe konsideroj se posta e ka pasur më herët të drejtën për me bërë pagesa bankare, ka pas licencë prej BQK-së pse nuk është zhvilluar; a duhet të hyjë Posta garancion, Posta është pronë e shtetit, nuk është më çështje e garancionit se ne mund të hyjmë në garancion, pa Postë mund të japim garancione shtetërore, dhe nuk nevojë për Postën; të gjitha opsionet të cilat janë dhënë, janë kohore dhe çdo vonim që rrezikon kohën e çështjes dhe të trendëve ndërkombëtare, prandaj ju kisha lutur të gjithëve që të mobilizohemi që të gjithë dhe neve jemi në dispozicion që nëse ka nevojë që të vijë çdo ditë të vijmë me elaborime të sakta, keni në dispozicion një ekip edhe vendore edhe dua të them që përveç këshilltarit të transaksionit ka ekip vendore dhe ekspert vendor.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

- i. Shtyhet shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës për mbledhjen e radhës;*
- ii. MEF-i të sjell material dhe sqarime shtesë në bazë të çështjeve të ngritura në këtë takim.*

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210

Kryetarja – I njoftoi deputetët së grupi i punës ka hartuar Raportin për këtë Projektligj, dhe ia kaloi fjalën kryesueses së Grupit punues znj. Sala Berisha – Shala.

Sala Berisha – Shala - paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210, si në vijim: **Amendamenti 1** fshinë paragrafin 1 të Nenit të Projektligjit; **Amendamenti 2**, Neni 2 i Projektligjit fuzionohet në Nenin 1 të Projektligjit, Ndërsa të gjithë nenet e mëposhtme të Projektligjit me automatizëm pësojnë për një numër (Neni 3 behet 2, Neni 4 bëhet 3 etj.); **Amendamenti 3**, Neni 4 Fshihet fjala: tregtare; **Amendamenti 4**, Neni 5 Paragrafi 2 i Nenit 5 të Projektligjit behet Nen i ri 5. Ndërsa nënparagrafët 2.1, deri 2.5 behen paragraf të Nenit të ri 5; Ndryshohet afati 30 ditë për ankesën në paragrafin 2.1, 2.3 dhe 2.5 të Nenit 5 të Projektligjit dhe behet 15 ditë. Ndërsa afati 15 ditë për ankesën në paragrafin 2.2 të Nenit 5 të Projektligjit behet 8 ditë. Paragrafët 2.2, 2.3 dhe 2.4 të Nenit 5 ndryshohen si vijon: 2. Nëse Kryeshefi i ARBK-së, nuk vendos apo e refuzon ankesën, parashtruesi i saj me afatin prej 8-të ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit, mund ti parashtroj ankesë organit të caktuar të MTI-së. 3. Komisioni për Parashtrësia dhe Ankesa i MTI-së, është i autorizuar dhe përgjegjës për ta vendosur ankesën nga paragrafi 3 i këtij Neni, brenda 15 ditë nga pranimi i sajë. 4. Nëse Komisioni për Parashtrësia dhe Ankesa i MTI-së, me aktvendim e miraton ankesën nga paragrafi 4 i këtij Neni, ai do të kërkoj nga Kryeshefi i ARBK-së, për ta zbatuar atë aktvendim brenda afatit ligjor; **Amendamenti 5** Paragrafi 3 i Nenit 5 behet Nen i ri 6. Paragrafi 4, dhe nënparagrafët 4.1 dhe 4.2 behen paragraf të Nenit të ri 6; **Amendamenti 6** Paragrafi 5 i Nenit 5 behet Nen i ri 7. Paragrafi 6 bëhet paragrafi 2 i Nenit të ri 7. Zëvendësohet fjalia: Zyrës dhe behet “Agjencisë”; **Amendamenti 7** Paragrafi 7 i Nenit 5 behet Nen i ri 8. Paragrafët 8 nënparagrafi 8.1 bëhen paragraf të Nenit të ri 8; **Amendamenti 8** Paragrafi 9 i Nenit 5 behet Nen i ri 9. Paragrafët 9.1 dhe 9.2 bëhen paragraf të Nenit të ri 9; **Amendamenti 9** Neni 6 i Projektligjit behet Neni 10; **Amendamenti 10** Paragrafi 2 i Nenit 6 të Projektligjit behet Nen i ri 11. Paragrafi 2.1 behet paragrafi 2 i Nenit të ri 11; Fshihet Pika h), i) dhe j) të Nenit 33 të Ligjit në fuqi; **Amendamenti 11** Paragrafi 3 i Nenit 6 të Projektligjit behet Nen i ri 12. Paragrafët 4 dhe 5 të Nenit 6 bëhen paragraf të ri 2 dhe 3 të Nenit të ri 12; **Amendamenti 12** Paragrafi 6 i Nenit 6 të Projektligjit behet Nen i ri 13. Ndërsa paragrafi 7 i nenit 6 behet paragrafi 2 i Nenit të ri 13; **Amendamenti 13** Paragrafi 8 i Nenit 6 të Projektligjit behet Nen i ri 14.

Paragrafi 9 i Nenit 6 behët paragrafi 2 i Nenit të ri 14; **Amendamenti 14** Paragrafi 10 i Nenit 6 të Projektligjit behët Nen i ri 15. Paragrafi 11 i Nenit 6 behët paragrafi 2 i Nenit të ri 15; Fjalët: gjuhën shqipe, serbe apo angleze, zëvendësohen më: gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës; **Amendamenti 15** Paragrafi 12 i Nenit 6 të Projektligjit behet Nen i ri 16; **Amendamenti 16** Paragrafi 13 i Nenit 6 të Projektligjit behet Nen i ri 17; **Amendamenti 17** Neni 7 i Projektligjit behet Neni 18; Shtohen paragrafët e rinj: 1. Neni 79 i Ligjit fshihet në tërësi. 2. Në tërë tekstin e Ligjit fshihet fjala “kapital themeltar për shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar”. Paragrafi 1 i Nenit 7 të Projektligjit behet paragraf 3, ndërsa paragrafi 2 behet 4; **Amendamenti 18** Paragrafi 3 i Nenit 7 të Projektligjit behet Nen i ri 19; **Amendamenti 19** Paragrafi 4 i Nenit 7 të Projektligjit behet Nen i ri 20; **Amendamenti 20** Paragrafi 5 i Nenit 7 të Projektligjit behet Nen i ri 21; **Amendamenti 21** Paragrafi 7 i Nenit 8 të Projektligjit behet Nen i ri 22; **Amendamenti 22** Paragrafi 8 i Nenit 7 të Projektligjit behet Nen i ri 23; **Amendamenti 23** Në nenin 184.4 të Ligjit në fuqi, shtohet teksti: Në rast se Drejtori ose ndonjë anëtar i Bordit të Drejtorëve gjatë ushtrimit të detyrës përfiton personalisht ose kryen ndonjë veprim në dëm të kompanisë, konsiderohet vepër penale dhe do të jetë përgjegjës sipas ligjeve pozitive që janë në fuqi; **Amendamenti 24** Në nenin 232 të Ligjit në fuqi, paragrafi 1 pika a) fshihet fjalia “mos” në rreshtin e parë; **Amendamenti 25** Paragrafi 9 i Nenit 8 të Projektligjit behet Nen i ri 24; **Amendamenti 26** Neni 8 Projektligjit behet Nen i ri 25 dhe ndryshohet si vijon: Më hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha ligjet dhe aktet tjera nënligjore që janë në kundërshtim më këtë ligj; **Amendamenti 27** Neni 9 i Projektligjit bëhet Nen i ri 26;

Vërejtjet:

Amendamenti 6

Paragrafi 5 i Nenit 5 behet Nen i ri 7. Paragrafi 6 bëhet paragrafi 2 i Nenit të ri 7. Zëvendësohet fjalia: Zyrës dhe behet “Agjencisë”;

Zef Morina – paraqiti vërejtje në pjesë në dytë të amendamentit dhe pyeti se pse “zyreja të shndërrohet në Agjenci”?

Ibrahim Krasniqi konsulent – tha për shkak së tani me kjo është duke ushtruar veprimtari si Agjenci dhe është më funksionale, të jetë Agjenci e jo zyre.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23

Në nenin 184.4 të Ligjit në fuqi, shtohet teksti: Në rast se Drejtori ose ndonjë anëtar i Bordit të Drejtorëve gjatë ushtrimit të detyrës përfiton personalisht ose kryen ndonjë veprim në dëm të kompanisë, konsiderohet vepër penale dhe do të jetë përgjegjës sipas ligjeve pozitive që janë në fuqi;

Zef Morina – paraqiti vërejtje dhe pyeti së pse është sanksionuar kjo dispozitë si vepër penale?

Ethem Çeku – për shkak së kemi dashur të sanksionojmë keqpërdorimet që do të mund të ndodhnin nga drejtoret e kompanive dhe qëllimisht i kemi kualifikuar si vepër penale.

Qamile Morina – tha se do të duhej që fjalia e fundit të jetë “sipas dispozitave ligjore.”

Adem Salihaj – tha se duhet të jetë fjalia e fundit vetëm: “sipas ligjit”.

Komisioni vendosi që fjalitë e fundit të amendamentit 23: “konsiderohet vepër penale dhe do të jetë përgjegjës sipas ligjeve pozitive që janë në fuqi”, formulohet në këtë formë: “konsiderohet vepër penale dhe do të jetë përgjegjës sipas ligjit”.

Amendamenti 24

Në nenin 232 të Ligjit në fuqi, paragrafi 1 pika a) fshihet fjalia “mos” në rreshtin e parë;

Ibrahim Krasniqi konsulent – tha se ky amendament duhet të ndryshohet për shkak së është i pakuptimtë dhe shkakton konfuzion në zbatimin e ligjit. Dhe propozoj që të fshihet në tërësi amendamenti.

Zef Morina – po ashtu u pajtua me fshi amendamentin.

Adem Grabovci – tha se duhet të fshihet propozimi në amendament sepse është në rregull që bizneset të kenë një Raport vjetor të dorëzuar ose së paku një kopje në Agjenci për Regjistrimin e bizneseve.

Mehdi Pllashniku – MTI-ARBK – sqaroj se propozimi amendamenti është me vend dhe nuk ka nevojë të fshihet për shkak së interferohet në nenet 42 dhe 43 të Ligjit në fuqi sepse ato nene janë fshirë tashme.

Adem Salihaj – propozoj që Amendamenti 24 mos të fshihet por të riformulohet në këtë formë: “Fshihet pika a) e paragrafit 1 të nenit 232 të Ligjit në fuqi.”. Sepse nëse e hjekim fjalën “mos” i bie që biznesi apo kompanisë ti mbyllet veprimtaria nëse e dorëzon Raportin.

Komisioni vendosi që Amendamenti 24 të këtë formë: “Fshihet pika a) e paragrafit 1 të nenit 232 të Ligjit në fuqi.”

Pas debatit Komisioni më nëntë (9) vota Për dhe një (1) vota Kundër nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210 më vërejtjet e paraqitura.

5. Të ndryshme

i) Rekomandimet për BQK

Kryetarja – kërkoj nga Grupi punues që të hartohen Rekomandimet për BQK në një afat sa më optimal të mundshëm dhe të procedohen për seance.

ii) Monitorimi i Ligjit nr. 2002/7 për Telekomunikacionin

Kryetarja – I njoftoi deputetet që është realizuar një Takim zyrtar në PTK dhe kërkoj nga kryesuesi i Grupit punues që të organizoj një Dëgjim Publik në lidhje me këtë çështje.

Zef Morina – propozoj që Dëgjimi publik të organizohet më datë 14.07.2010 ditë e mërkure, në ora 12:00.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

- i. Grupi punues për Monitorimi i Ligjit nr. 2002/7 për Telekomunikacionin do të organizoj Dëgjim Publik më datë 14.07.2010 në ora 12:00 në ambiente e Kuvendit;
- ii. Agjenda do të përgatitet nga Stafi mbështetës i Komisionit.

iii) Projektligjet e energjisë

Kryetarja – Kërkoj nga Grupi punues z. Ethem Çeku, Myzejene Selmani, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi dhe Adem Grabovci, të përgatitën në muajin korrik të këtij viti për amendamentimin e Projektligjeve të energjisë, sepse duke u bazuar në planin e punës së Komisionit, këto Projektligje është dashur që të procedohen deri më tani bë seance për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 30

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani